



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3305 Prot.

Tiranë, më 31/10/2023

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA .

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Baza Ligjore: Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të gjendur përballë një situatë të paprecedentë të zhvillimit të seancës plenare të datës 30.10.2023, ku deputetët e opozitës në thyerje të rëndë të Rregullores së Kuvendit dhe të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, bllokuan foltoren e Kuvendit, hoqën kartat nga pajisjet elektronike të deputetëve të Grupit Parlamentar të PS të cilët ishin të regjistruar për të diskutuar mbi çështjet e evidentuara nga zgjedhësit .

Situata arriti deri në përplasje fizike midis deputetit Vullnet Sinaj dhe deputetit Bledion Nallbati.

Shërbuesit
Në Moxe duat
Stuinet alle etikën
31/10/2023

Deputetët Flamur Noka, Gazmend Bardhi, Bledion Nallbati, Edi Paloka, Albana Vokshi penguan zhvillimin normal të seancës plenare që në nisje të saj duke zaptuar foltoren, si dhe duke mos lejuar diskutantët e regjistruar të mbanin fjalën e tyre.

Deputeti Flamur Noka nuk lejoi asnjë deputet të regjistruar të mbante fjalën duke i'u afruar e penguar gjatë diskutimit. Gjithashtu deputeti Noka i hoqi kartën nga pajisja deputetit Ismet Beqiraj duke mos e lejuar që të përfundonte fjalën.

Deputeti Gazmend Bardhi përveç veprimeve të mësipërme tentoi të godiste Kryetaren e Kuvendit me shishen ujit e cila ishte në foltore. Gjithashtu deputeti Bardhi gjatë kohës që deputetja e Partisë Socialiste Klodiana Spahiu u ngrit për të mbajtur fjalën e saj, ai i hoqi kartën nga pajisja elektronike duke i hequr kështu të drejtën për të folur.

Deputeti Edi Paloka pengoi deputetët e Partisë Socialiste të mbanin fjalën e tyre, u bë pjesë e konfliktit mes deputetëve Nallbati dhe Sinaj duke debatuar, si dhe gjatë kohës që deputeti Bujar Çela po fliste i hoqi kartën nga pajisja elektronike duke i hequr të drejtën e fjalës.






Deputetja Albana Vokshi pengoi gjatë gjithë kohës zhvillimin normal të seancës plenare, si dhe gjatë kohës që deputeti Fadil Nasufi mori fjalën i hoqi kartën nga pajisja elektronike duke mos e lejuar të fliste.

Deputetët Saimir Korreshi dhe Lefter Gështhenja penguan zhvillimin normal të seancës duke bllokuar foltoren.

Sa më sipër, bazuar në nenin 63, pika 1 gërma d), dhe nenin 65/I të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 3, gërma dh) dhe ë), nenin 8, pika 2 gërma b) dhe nenin 33 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën si më poshtë:

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Gazmend Bardhi, Bledion Nallbati, Flamur Noka, Edi Paloka, Albana Vokshi, Saimir Korreshi dhe Lefter Gështhenja.
- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT

- ① Ili Metaj 
- 2 Bujar Gëzi 
3. Gentë Duroku 
- 4 Enxhemir Zeka 
5. Prokuror Resulez 
6. Antonet Shumë 
7. Gjyresha Marraj 
8. Ilirion Pendarinj 
9. EDUARDO SMAN 
10. Bledar Jusi 
- 11 - Ili Topi 
12. Bandyll Kollçari 
13. TONI GOGU 